



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

**VENDIM**

Nr. 33 date 02.08.08

**Per rishqyrtimin e procedures se transformimit te Ndermarjes Shteterore**  
**« Uzina e Instrumentave Korce » ne Shoqeri Tregetare dhe procedures per**  
**dhenien me enfiteoze**

Keshilli i Bashkise pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga anetaret e Keshillit Bashkiak”, dokumentacionin per ndjekjen e procedurave per transformimin e Ndermarjes Shteterore “Uzina e Instrumentave Korce ne Shoqeri Tregetare, dhe legjislacionin ne fuqi

**VEREN**

Me vendimin nr. 85 date 26.11.2007 Keshilli Bashkiak ka vendosur transformimin e “Uzines se Instrumentave Korce” nga Ndermarje Shteterore ne Shoqeri Tregetare. Ky transformim eshte realizuar konform dispozitave te ligjit 7926 date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregetare”, te ndryshuar ne baze te te cilit cdo ndermarje shteterore mund te transformohet ne shoqeri tregetare. Pas transformimit te gjitha keto ndermarje i nenshtrohen legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregetare.

Ne kushtet kur kjo shoqeri duhet te vendoset ne eficence, Keshilli Bashkiak pasi ka shqyrtuar propozimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise, me vendimin nr. 9 date 19.09.20008 ka vendosur te miratoje fillimin e procedurave per dhenien me enfiteoze te siperfaqes prej 22 670 m<sup>2</sup> te ish UIK per tu perdorur me qellim ushtrimin e veprimtarive

ekonomike dhe sherbimeve tregtare me afat kohor deri ne 20 vjet, me tarife te detyrimit mujor 1 603 830 lek ne muaj.

Ne baze te VKM 1712 date 24.12.2008 “Per dhenien me qera ose enfiteoze te pasurive shteterore” kur objekti qe jepet me qera eshte ne administrim te shoqerive ku zoteruesi i aksioneve eshte shteti nuk eshte e nevojshme marja e konfirmimit nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme dhe Agjensia e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave.

Pra mos marja e konfirmimit nga keto dy institucione nenkupton te drejten qe ka institucioni shteteror qe zoteron aksionet per te gezuar dhe perdorur lirisht dhe ne menyre te pavarur sendin, por kjo nuk do te thote qe pronareve ju humbet e drejta e parablerjes mbi truallin por ne te njejten kohe nuk mund te pretendojne edhe per pagesen e qirase te truallit pasi Bashkia dhe Keshilli Bashkiak nuk mund te marrin persiper nje detyrim qe nuk buron nga asgje ligj apo akt nenligjor.

Per sa me siper dhe bazuar ne nenin 32 te ligjit 8652 date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjin 7926 date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, te ndryshuar, ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “ dhe VKM 1712 date 24.12.2008 “Per dhenien me qera ose enfiteoze te pasurive shteterore”

## VENDOSI

1. Te lere ne fuqi vendimin nr. 85 date 26.11.2007 te Keshillit Bashkiak “Per transformimin e “Uzines se Instrumentave Korce” nga Ndermarje Shteterore ne Shoqeri Tregtare”
2. Te lere ne fuqi vendimin nr. 9 date 19.09.2008 te Keshillit Bashkiak “Per fillimin e procedurave per dhenien me enfiteoze te siperfaqes prej 22 670 m 2 te ish UIK”
3. Te vazhdojne procedurat per dhenien me enfiteoze te siperfaqes prej 22 670 m 2 te ish UIK, sot “Korca 2008” sh.a
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen organet Drejtuese te Shoqerise “Korca 2008” sh.a.
5. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

**KRYETARE**

**Raimonda NASE**

*Raimonda Nase*